

SURETUL HUXHURAT

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit Mëshirplotit

“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t’u këshilluar me të mendarët.” (Sad, 29)

Kur’ani Kerim është libri i fundit qiellor dhe më i ploti, i cili ka zbritur për udhëzimin e njerëzve. Ky libër është në përshtatje me natyrën e njerëzve dhe me logjikën e tyre.

Gjatë gjithë shekujve, Kur’ani ka luajtur rol të rëndësishëm në edukimin e njerëzve e sidomos dijetarëve, të cilët ndriçojnë qiellin e banorëve të tokës njësoj si yje të pashuar. Ata i japin kuptim historisë së njerëzimit dhe janë shkak i lëvizjeve reformuese në popujt besimtarë. Shumica e mendimtarëve dhe udhëheqësit e vërtetë kanë përfituar prej ujit të kthjellët të këtij burimi të pashtershëm.

Historia dëshmon, se në çdo kohë që njerëzit në përgjithësi dhe muslimanët në veçanbti, iu drejtuan Kur’anit, kanë rrezatuar krenari, lumturi dhe qytetërim (civilizim). Po ashtu, historia tregon se kur u larguan nga Kur’ani, ose u mjaftuan vetëm me kuptimet sipërfaqësore të tij, ata nuk kanë arritur ta gjejnë krenarinë dhe qytetërimin e kërkuar dhe nuk mundën të arrijnë në majat e qytetërimit.

Al’lillahu (xh.sh.) me mirësinë e Tij, nuk i ka lënë njerëzit në asnjë kohë pa udhërrëfyes, që t’i drejtojnë ata drejt vlerave të larta morale.

Fondacioni i Kur’anit, në vazhden e përgatitjes dhe hartimit të teksteve mësimore të cilat kanë të bëjnë me Kur’anin, mes të cilave “Mësimi i leximit të Kur’anit”, Metoda e Hifzit” dhe përpikëria e leximit, ka nderin t’u paraqesë lexuesve komentimin e sures El Huxhurat që është edhe punimi i parë i ciklit “Burime Rrezatuese”. Ky punim është marrë nga Tefsiri “El Emthel” i autorit Nasir Mekarim Esh Shirazij, i cili është një prej komentuesve bashkëkohorë më në zë të Kur’anit Famëlartë. E nisim këtë cikël me komentimin e sures Hxhurat, e cila njihet edhe i “Sureja e Moralit”, sepse gjëja më kryesore për të cilën njeriu ka nevojë gjatë jetës së tij të përditshme është pikërishtmorali. Është ai moral i përfituar nga mësimet kur’anore, në bazë të të cilit njeriu ngre marrëdhëniet shoqërore, rrezaton harmoni e paqe në shoqëri dhe “shtron” rrugën e tij për te Zoti i Gjithësisë.

Duke shpresuar që ky nga ky libër të përfitojnë jo vetëm individët por edhe institucionet dhe qendrat arsimore, lusim All’llahun e Lartësuar që autorit dhe lexuesve t’u dhurojë suksese në të gjitha fushat e jetës.

Së fundi, dua të shpreh konsideratën dhe falenderimet e mia të përzemërta për të gjithë ata që bashkëpunuan në përgatitjen e këtij libri.

Me nderime

Hossein ASADI

Drejtori i Fondacionit të Kur’anit

Mësimi i parë

SURETUL HUXHURAT

Vendzbritja: Medine

Nr. i Ajeteve: 18

Nr. i fjalëve: 343

Nr. i shkronjave: 1496

Emërtime të tjera: Etika, Morali

Përmbajtja e sures

Kjo sure, e cila ka 18 ajete, mbart çështje mjaft të rëndësishme që kanë të bëjnë me personalitetin e Profetit Muhammed (s.a.v.s) dhe me shoqërinë islame. Shumica e çështjeve që trajton, kanë të bëjnë me moralin dhe për këtë arsye, kjo sure është quajtur **“Sureja e moralit dhe etikës”**. Përmbajta e saj mund të ndahet si vijon:

Pjesa e parë: Ajetet e para të kësaj sureje, të cilat sqarojnë mënyrën e sjelljes me të Dërguarin e Allahut (xh.sh), etikën e sjelljes dhe ç’duhet të kenë parasysh muslimanët kur ndodhen tek Profeti.

Pjesa e dytë: Kjo sure përmbledh një sërë bazash të moralit shoqëror. Nëse zbatohen dhe ecet sipas tyre, në shoqëri, veçanërisht në shoqërinë islame, do të sundojë dashuria, singëriteti, siguria, uniteti etj. E kundërta do të ndodhë, nëse këto baza nënvleftësohen dhe si pasojë, do të sundojë urrejtja, hipokrizia, pasiguria, përçarja etj.

Pjesa e tretë: Përmban dispozita udhëzuese që kanë të bëjnë me mënyrën e të përballurit me mosmarrëveshjet, konfliktet, apo luftrat që mund të ndodhin ndonjëherë në mesin e muslimanëve.

Pjesa e katërt: Flet për vlerat e njeriut tek Allahu dhe rëndësinë e devotshmërisë.

Pjesa e pestë: Trajton çështjen se, besimi (përveç atij me zemër), nuk është vetëm me fjalë, por duhet patjetër që të shfaqen ndikimet e tij nëpërmjet veprave të mira dhe sakrificave në rrugën e Allahut me pasurinë dhe veten.

Pjesa e gjashtë: Flet për faktin se imani (besimi) dhe islami, janë dhuratë hyjnore për besimtarët dhe se ata, në vend që të mburren me imanin dhe

islamit e tyre, duhet të falenderojnë Allahun për këtë dhuratë të përsosur e të çmuar.

Pjesa e shtatë: Pjesa e fundit flet rreth diturisë së Allahut, të Cilit nuk i fshihet asgjë, qoftë e dukshme apo e fshehur pra, është i Gjithdijsëm dhe i Mirinformuar për të gjitha sekretet e njeriut, sado që të mundohet njeriu t'i fshehë ato.

Emërtimi i kësaj sureje me këtë emër, *"El Huxhurat"*, është për shkak se në ajetin e katërt të sures përmendet kjo fjalë, të cilën do ta sqarojmë më poshtë.

Mirësitë e leximit të kësaj sureje

Profeti Muhammed (s.a.s) ka thënë: *"Ai që lexon suren El Huxhurat, do t'i jepen shpërblim dhjetë të mira me numrin e njerëzve që besuan Allahun dhe atyre që e mohuan"*. Është e natyrshme se i gjithë ky shpërblim që është me numrin e adhuruesve dhe joadhuruesve, është në atë formë, që kur të shikojmë të dy grupet, të mendohemi thellë dhe të ndjekim rrugën e adhuruesve e të largohemi nga rruga e mëkatarëve dhe mohuesve.

Pyetje:

- 1- Cili është shaku i emërtimit të kësaj sureje me emrin "El Huxhurat"?**
- 2- Përmendni se për çfarë bën fjalë kjo sure?**

Mësimi i dytë

Ajetet: 1-5

“O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshtëm.”

“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare.”

“Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh.”

“Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh.”

“E sikur të duronin derisa ti të dilje jashtë tek ata, do të ishte më mirë për ata. Por Allahu është Falës dhe Mëshirues.”

Shkaqet e zbritjes.

Disa komentues, rreth zbritjes së ajetit të parë përmendin një, madje disa shkaqe, po ashtu rreth ajeteve në vazhdim, përmendin shkaqe të tjera.

Prej çështjeve që përmendin si shkak të zbritjes së ajetit të parë është:

Kur Profeti vendosi të drejtohej drejt Hajberit (për luftë), kishte dëshirë që të linte një person të caktuar në vend të tij në Medinë dhe ta caktonte zëvendës të tij. Umeri propozoi një person tjetër. Atëherë zbriti ajeti i parë duke urdhëruar që të mos dalin para Allahut dhe të Dërguarit të Tij. (Tefsir Kurtubiu V. 9. F. 6121).

Komentues të tjerë thonë: Disa muslimanë herë pas here thoshin: “Sikur të zbresë për ne një ajet, do të ishte më mirë!”. Atëherë zbriti ajeti: **“Mos dilni para Allahut dhe të Dërguarit të Tij ...”**

Të tjerët thonë: Ajeti tregon për veprat e disa muslimanëve, të cilët i kryenin ibadetet e tyre para kohe dhe për këtë zbriti ajeti që t'i ndalojë ata nga ky veprim.

Ndërsa, rreth ajetit të dytë komentuesit kanë thënë se një grup njerëzish prej fisit “Temim” shkuan në Medinë. Kur hynë në xhaminë e Profetit, thirrën me zë të lartë nga prapa dhomave në të cilat qëndronte Profeti (s.a.s): **“O Muhamed, dil tek ne”**. Kjo mënyrë e të thirrurit pa kulturë, e shqetësoi Profetin. Ai (s.a.s) doli tek ata. Ata i thanë: “Kemi ardhur tek ti që të krenohemi, prandaj lejo poetin

dhe oratorin tonë që të përmendin krenarinë e fisit tonë. Profeti u dha leje, dhe oratori i tyre u ngrit e filloi të fliste rreth krenarisë dhe virtyteve të tyre imagjinare...

Profeti urdhëroi Thabit ibn Kajsin (oratori i ensarëve dhe i Profetit) që t'u përgjigjet atyre. Ai u ngrit dhe mbajti një ligjëratë me retorikë të lartë dhe ligjëratës së tyre nuk i mbeti asnjë ndikim. Pastaj u ngrit poeti i tyre dhe recitoi disa vargje poezish duke lavdëruar fisin e tyre. Më vonë u ngrit Hasan ibn Thabit (poeti i Profetit) duke iu përgjigjur atyre me një poezi me mjaft vlera.

Një person i njohur i atij fisi, i quajtur El-Ekra'ë, u ngrit e tha: "Vërtet ky burrë (e kishte fjalën për Profetin), oratori i Tij është më lart se oratori ynë dhe poeti i tij (poeti i Profetit) është më i famshëm se poeti ynë. Jehona e zërit të tyre shkon më larg se zëri ynë.

Profeti urdhëroi që atyre t'u jepnin dhurata, me qëllim që të ndikonin në zemrat e tyre. Ata u ndikuan së tepërmi nga kjo sjellje dhe e pranuan profetësinë e Profetit (s.a.s).¹

Gjendet një tjetër ngjarje apo histori rreth zbritjes së këtij ajetit, por ajo ka lidhje edhe me ajetet që vijnë më pas e kjo ngjarje (histori) është:

"Në vitin e nëntë të hixhrit (vit në të cilën fiset shkonin tek Profeti e i jepnin besën atij dhe për këtë arsye e quajtën "Viti i delegatëve", ku përfaqësuesit e fisit Temim mbërritën tek Profeti (s.a.s). Ebu Bekri tha: Të jetë "El-Ka'Kaa" (njëri prej të njohurve në fis) prijësi i tij. Umeri propozoi "El-Habis ibn Akra" prijës të fisit. Ebu Bekri i tha Umerit: Ti deshe të më kundërshtoje me atë veprim tëndin? Umeri i tha: " Jo, nuk e bëra për të të kundërshtuar. Në ato momente zërat u ngritën në mes tyre dhe zbritën ajetet e mësipërme, kuptimi i të cilave është: **"... pra, mos propozoni gjë pas propozimit të Profetit, mos kryeni gjë para Tij dhe as mos ngreni zërat tuaj në shtëpinë e Tij..."**".²

Të tjerët thoinë: Ajeti tregon për veprat e disa muslimanëve , të cilët I kryenin ibadetet e tyre para kohe dhe për këtë zbriti ajeti që t'I ndalojë ata nga ky veprim.³

Ndërsa rreth ajetit të dytë, komentuesit kanë thënë se një grup njerëzish prej fisit "Temim" shkuan në Medine. Kur hynë në xhaminë e Profetit, thirrën me zë të lartë nga prapa dhomave në të cilat qëndronte profeti (s.a.v.s): "O Muhamed, dil tek ne!". kjo mënyrë e të thirrurit pa kulturë, e

¹ Tesfiri Kurtubijj V.9.F.6121.

² Po aty.

³ Tesfiri Kurtubijj V.9.F.6121.

shqetësoi profetin. Ai (s.a.v.s) doli tek ata. Ata I thanë: Kemi ardhur tek ti që të krenohemi, prandaj lejo poetin dhe oratorin tonë që të përmendin krenarinë e fisit tonë. Profeti u dha leje dhe oratori I tyre u ngrit e filloi të fliste rreth krenarisë dhe virtytetve të tyre imagjinare.

Profeti urdhëroi Thabit ibn Kajsin (oratori I ensarëve dhe I profetit) që t'u përgjigjet atyre. Ai u ngrit dhe mbajti një ligjëratë me retorikë të lartë dhe ligjëratës në tyre nuk I mbeti asnjë ndikim. Pastaj u ngrit poeti I tyre dhe recitoi disa vargje poezish duke lavdëruar fisin e tyre. Më vonë u ngrit Hasan ibn Thabit (poeti I Profetit) duke iu përgjigjur atyre me një poezi me mjaft vlera.

Një person I njohur I atij fisi I quajtur El Ekra', u ngrit e tha: "Vërtet, ky burrë (e kishte fjalën për profetin), oratori I tij është më lart se oratori ymë dhe poeti I tij (poeti I Profetit) është më I famshëm se poeti ynë. Jehona e zërit të tyre shkon më larg se zëri ynë.

Profeti urdhëroi që atyre t'u jepnin dhurata me qëllim që të ndikonin në zemrat e tyre. Ata u ndikuan së tepërmi nga kjo sjellje dhe e pranuan profetësinë e Profetit (s.a.v.s)!

Gjendet një tjetër ngjarje apo histori rreth zbritjes së këtij ajeti, por ajo ka lidhje edhe me ajetetb që vijnë më pas e kjo ngjarje (histori) është:

"Në vitin e nëntë të hixhrit (vit në të cilin fiset shkonin te profeti e I jepnin besën atij dhe për këtë arsye e quajtën viti I delegatëve", ku përfaqësuesit e fisit Temim mbërritën te Profeti (s.a.v.s) Ebu Bekri tha: "Të jetë El Ka'ka'" (njëri prej të njohurve të fisit) prijës I tij. Umeri propozoi "El Habis ibn Akra" prijës të fisit. Ebu Bekri I tha Umerit: Ti deshe të më kundërshtoje me atë veprimn tënd? Umeri I tha: "Jo, nuk e bëra për të të kundërshtuar. Në ato moment e zërat u ngritën në mes tyre dhe zbritën ajetet e mësipërme, kuptimi I të cilave është:

"... Pra, mos propozoni gjë pas propozimit të Profetit, mos kryeni gjë para tij dhe as mos ngreni zërat tuaj në shtëpinë e tij..."⁴

⁴ Këtë e ka përcjell Kurtubiu në Tefsirin e tij: Vëll 9, Fq. 6121.) Sejjid Kutub në Tefsirin e tij "Edh Dhilal": Vëll. 7, Fq. 524, Ibn Hishami në "Historinë" e tij: Fq. 206, Buhariu në Sahihun e tij: Vël. 6, Fq. 172 (në tefsirin e sures Huxhurat)

Pyetje:

- 1- Përmendi një ndodhi rreth shkakut të zbritjes së ajetit.**
- 2- Pse Profeti (s.a.v.s) urdhëroi t'I jepnin dhurata atij grupi njerëzish, të cilët erdhën për t'u krenaruar para tij me poetin e tyre? Ka ndonjë shkak ky veprim I Profetit?**

Mësimi i tretë

Rregullat e qëndrimit tek Profeti (s.a.v.s)

Siç e përmendëm edhe më lart, kjo sure përmban udhëzime të rëndësishme rreth moralit dhe për këtë është quajtur “sureja e moralit”. Këto ajete përmbajnë dy lloje udhëzimesh:

I pari: Mos propozimet para Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Rreth këtij udhëzimi ajeti i parë thotë: **“O ju që keni besuar mos propozoni...”**

Fjala “mos propozoni”, këtu ka kuptimin që të mos bëhet propozim në hartimin e dispozitave të Sheriatit para se Allahu dhe i Dërguari i Tij të japin vendimet e tyre dhe të mos nxitohen para urdhërit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

S’ka dyshim se përgjegjësia e disiplinimit të të tjerëve nën udhëheqjen e një udhëheqësi, e veçanërisht nën udhëheqjen e të zgjedhurve të Allahut, kërkon që të mos avancojë kush në propozime dhe të mos nxisojë kush para Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Natyrisht, kjo nuk do të thotë se atyre nuk u lejohet konsultimi (shûrâ) me Profetin, nëse ata kanë diçka që duhet ta shfaqin, por që të mos nxisojnë dhe të mos fillojnë me vendime para se të jetë dakort i Dërguari për atë gjë. Nuk duhet të shtrohen pyetje apo diskutime më tepër se ç’ka nevojë ajo çështje. Po ashtu, nëse pyetet i ruajturi, nuk kanë të drejtë të tjerët që t’i përgjigjen pyetësit para se t’i përgjigjet udhëheqësi. Vërtet, ajeti i përfshin të gjitha këto kuptime.

I dyti: Mosngritja e zërit tek Profeti.

Pikërisht, për këtë udhëzim flet edhe ajeti i dytë, në të cilin thuhet: **“O ju që keni besuar, mos i ngrini zërat tuaj mbi zërin e Profetit, e as mos i flisni atij me zë të lartë siç i flisni njëri-tjetrit, me qëllim që veprat tuaja mos të bëhen të pavlefshme dhe ju nuk e dini!”**

Fjala e parë: **{Mos i ngrini zërat tuaj mbi zërin e Profetit}**, tregon se nuk duhet të ngrihet zëri mbi zërin e Profetit, sepse ky lloj veprimi në vetvete, është jashtë etike gjatë ndodhjes para Profetit (s.a.s), për shkak se Profeti ka pozitën e tij të veçantë. Po kështu, kjo gjë nuk duhet të ndodhë as para prindërve dhe mësuesve, sepse është në kundërshtim me respektin dhe mirësjelljen.

Ndërsa fjalia: **{Mos i flisni atij me zë të lartë}**, mund të jetë përforcim i kuptimit të fjalisë së parë, ose tregon për diçka tjetër, që është ndalimi i të thirrurit të Profetit “O Muhammed” dhe zëvendësimi i tij me “O i Dërguar i Allahut”.

Mirëpo, disa komentues, përmendin një dallim mes dy fjalive të lartpërmendura. Ata thonë: *Fjalia e parë bën fjalë për kohën kur njerëzit bashkëbisedonin me Profetin dhe nuk duhet që ndonjëri ta ngrejë zërin e tij mbi zërin e Profetit (s.a.s), ndërsa fjalia e dytë flet për kohën kur Profeti ishte në heshtje dhe shokët i flisnin atij. Pra, edhe në këtë situatë nuk duhet të ngrihet zëri në praninë e tij.*

Por, në bashkimin e dy kuptimeve nuk gjendet problem, meqenëse janë të njëjtë me shkakun e zbritjes së ajetit.

Sido që të jetë, në pamje të jashtme, ajeti sqaron dy pika që janë të ndryshme.

Është e natyrshme se të njëjtat me këto veprime, nëse kanë si qëllim ofendimin e personalitetit të Profetit si dhe të pozitës së tij të lartë, ato janë kufër dhe mëkat.

Nëse dikush kryen një vepër që konsiderohet “Kufër” (heteretizëm, mosbesim, dalje nga feja), atëherë sqarohet edhe shkakun i pavlefshmërisë së punëve, kufri, i cili është shkak i zhdukjes së shpërblimit të arritur nga kryerja e veprave të mira.

Dihet se shpërblimi ndaj disa punëve të mira, mund të zhduket (fshihet) për shkak të kryerjes së disa mëkateve të veçanta, po kështu, disa mëkate bien (zhduken, fshihen) përshkak të kryerjes së disa veprave të mira. Për këtë flasin mjaft ajete të Kur’anit si dhe hadithe të Profetit Muhamed (s.a.v.s.).

Edhe pse, kjo nuk është konstatuar që të jetë ligj i përgjithshëm për të mirat (sevapet) dhe të këqiat (mëkatet), ka argumente tekstorë (ajete dhe hadithe) në lidhje me disa të mira e të këqija të rëndësishme dhe nuk ka argument llogjik në kundërshtim me argumentin tekstor.

Në një hadith transmetohet se, kur zbriti ajeti i lartpërmendur, Thabit ibën Kajsi tha: *“Unë jam ai që e kam ngritur zërin tim mbi zërin e Profetit, për këtë, punët e mia kanë rënë, dhe unë jam prej banorëve të Zjarrit”*. Kjo gjë i ra në vesh Profetit dhe tha: *“Ai është prej banorëve të Parajsës⁵, sepse kur vepronte në atë mënyrë me besimtarët apo përballë kundërshtarëve, ajo ishte detyrë e*

⁵ Shih Mexhmaul Bejan: Vëll. 9, Fq. 130; Tefsirin e Sejjid Kutubit, Sahihun e Buhariut

islamit. Gjithashtu, ibën Abbas ibën Abdul Muttalib me urdhër të Profetit thirri me zë të lartë ata të cilët u larguan nga beteja e “Hunejnit” që të kthehen në fushën e betejës.

Në ajetin tjetër dëshmohet shpërblimi i premtuar nga Allahu për ata të cilët zbatojnë urdhërat e Tij dhe kujdesen për sjelljen kur ndodhen tek Profeti. Në ajet thuhet: *“Ata të cilët i ulin zërat e tyre tek i Dërguari i Allahut, atyre Allahu ua ka sprovuar zemrat e tyre me devotshmëri. Për ata do të ketë mëshirë dhe shpërblim të madh”*.

Origjina e fjalës “jeguddune” është “gadde”, kuptimi I së cilës është ulja e shikimit ose ulja e zërit (këtu) dhe ka si antonym zgjatjen e vështrimit dhe ngritjen e zërit.

Ndërsa origjina e fjalës “imteheene” është nga “Imtihan”, e cila etimologjikisht nënkupton shkriren e arit dhe pastrimin e tij nga papastërtitë, siç nënkupton hapjen (shtrirjen) e lëkurës dhe përgatitjen e saj për regjje. Më pas kjo fjalë u përdor për të nënkuptuar provimin dhe sprovën, kuptim të cilin e hasim edhe në ajetin e mësipërm. Pra, kjo fjalë në ajet nënkupton pastrimin e zemrës dhe përshtatjen e saj për pranimin e devotshmërisë (tekva)

Ajo që bie në sy është, se në ajetin e parë është përdorur fjala “Nebijj” ndërsa në këtë ajet është përdorur fjala “Resulullah”. Të dy ajetet tregojnë se te Profeti nuk ka asgjë nga vetja e tij por, ai është “Resulull-llah” (I Dërguari i Allahut) dhe “Nebij-juhu” (profeti i Tij). Pra, nëse ofendohet ai, është ofenduar Allahu dhe mirësjellja ndaj tij është mirësjellje ndaj Allahut.

Në këtë ajet fjalën “*magfireh*” (falje) e gjejmë në trajtën e pashquar sepse tregon madhështi dhe rëndësi, pra Allahu (xh.sh.), do të vendosë për ta, faljen e madhe dhe të plotë. Dhe, pasi ata të pastrohen nga mëkatet, Ai do t’i shpërblejë me shpërblim të madh, sepse në fillim është i domosdoshëm pastrimi prej mëkateve, pastaj të fitohet shpërblimi i madh nga ana e Allahut (xh.sh.). Ajeti i mëposhtëm tregon për paditurinë e atyre të cilët i hedhin (i lënë) urdhërat e Allahut pas shpinave të tyre dhe nuk i kuptojnë ato. Ajeti thotë: {S’ka *dyshim se ata që të thërrasin ty mbas huxhuratit, shumica e tyre nuk mendojnë*}.

Cila është ajo mendje e cila e shtyn njeriun ta ngrejë zërin para “ambasadorit” më të famshëm të Allahut dhe nuk interesohet për rregullat e thirrjes siç vepruan fisi “Temim” të cilët i thërritën Profetit me zë të mërzitshëm **“O Muhammed dil tek ne”**, duke e ditur aë ai (s.a.v.s) është në qendër të dashurisë dhe përkujdesjes hyjnore? Sa më shumë të përsoset

mendja e njeriut, aq më tepër shtohet sjellja dhe kultura e tij, po ashtu, aq më tepër i njeh vlerat morale. Ndërsa, mosrespektimi i sjelljeve dhe i mirësjelljes dhe i etikës është argument i mungesës së mendjes, ose me fjalë të tjera, mosrespektimi i etikës është vepër shtazore, ndërsa respektimi dhe interesimi për to është vepër njerëzore.

Në këto ajete Allahu duket sikur thotë që: “Unë jam Allahu, Jam i ditur për çdo gjë, kur flas i ruaj rregullat e sjelljes. Përse ju nuk i ruani ato rregulla kur flisni?”

Por ama, ka njerëz të cilët sipas zakoneve dhe pakujdesisë së tyre ngrejnë zërat, e për këtë Kur’ani, nëpërmjet kësaj metode don t’u tërheqë atyre vëmendjen, me qëllim që të mos i harrojnë rregullat e mirësjelljes dhe të vënë në funksion mendjet dhe logjikën e tyre kur të flasin.

“El-Huxhurat” është shumësi i fjalës “huxhretu” dhe këtu tregon për shtëpitë e grave të Profetit që ndodheshin pranë xhamisë. Origjina e fjalës “huxhretu” është tek fjala “El-Haxher” (gur) sipas rrënjës “El-haxhr” që do të thotë “pengesë” sepse gurët ndalojnë hyrjen e të tjerëve në të ndaluarat e jetës së njeriut.

Fjala “Uera” (prapa) ka kuptimin jashtë në çdo anë qoftë, sepse dyert e shtëpive ishin përballë xhamisë dhe të paditurit (në lidhje me çështje si këto), qëndronin aty dhe thërrisnin “**O Muhammed dil tek ne**”. (Atëherë, Kur’ani i ndaloi ata, nga ai veprim).

Në plotësim të kuptimit të ajetit në fundin e tij thuhet: {Sikur *ata të duronin derisa të dalësh tek ata, do të ishte më mirë për ata*}. Vërtet, nxitimi e shtyn njeriun që të arrijë qëllimin e tij me shpejtësi, por durimi dhe marja shtruar në një pozitë si kjo, janë ftues në mëshirën e plotë dhe shpërblimin e madh. Përderisa disa persona e kryen këtë gabim me padituri, por më vonë e kuptuan dhe u kthyen tek vetet e tyre pas zbritjes së ajetit, Kur’ani thotë se ata i përfshin falja (amnistia hyjnore) pas pendimit (*Allahu është mëshirues*).

Pyetje:

- 1- *Sa udhëzime përmend ajeti?*
- 2- *Çfarë tha Profeti për Thabit ibn Kajsin?*
- 3- *Si e thirrën njerëzit e fisit “Temim Profetin?”*
- 4- *Përse fjala “Magfireh” është përdorur në trajtën e pashquar?*
- 5- *Shpjegoni kuptimin e fjalës “Huxhurat”.*

Mësimi i Katërt

Mirësjellja është vlera më e shtrenjtë:

Islami interesohet mjaft rreth çështjes së ruajtjes së etikës së mirësjelljes dhe bashkëpunimit me të tjerët qoftë në rang individual apo shoqëror, duke urdhëruar që ky bashkëpunim të jetë mbi bazat e respektit dhe etikës morale. Kur lexojmë me kënaqësi jetëshkrimin e udhëheqësve në islam, shohim se ata zbatojnë pikat më delikate të moralit dhe etikës deri edhe me personat e thjeshtë.

Dihet se feja është kulturë, kulturë me Allahun, me të Dërguarin, me evlijatë (njerëzit e dashur tek Allahu), me profesorët, me prindërit, me dijetarët, me mendimtarët...etj. Një vështrim i thellë në ajetet e Kur'anit Famëlartë, zbulon se edhe Allahu (xh.sh) kur u drejtohet robërve të Tij, u drejtohet me respekt të plotë. Nëse çështja është e tillë, atëherë cila është detyra e njerëzve para Allahut? Si duhet të veprojnë?

Në disa burime islame lexojmë se kur zbritën ajetet e para të sures "El Mu'minun" e cila urdhëron për disa rregulla të islamit dhe prej tyre çështja e epërqendrimit dhe e druajtjes në namaz. Kur ka zbritur ky ajet, *"Profeti (s.a.s) nganjëherë e ngrinte kokën drejt qiellit kur ishte në namaz pastaj shikonte në tokë dhe nuk e ngrinte shikimin"*.⁶

Ngritja e zërit tek varri i Profetit (s.a.v.s)

Disa komentues dhe dijetarë kanë thënë se ajetet e mësipërme ndalojnë ngritjen e zërit në prani të Profetit (s.a.v.s) jo vetëm në të gjallë të tij, por edhe pas vdekjes së tij. (Ruhul Me'anij, Vëll. 26, Fq. 125).

Nëse qëllimi i tyre në thënien e mësipërme është se ajeti është përgjithësues në ndalimin e tij, atëherë në pamje të jashtme, kuptimi i drejtpërdrejtë i ajetit është i posaçëm për kohën kur Profeti (s.a.v.s) ishte i gjallë, sepse ajeti thotë: *"Mos i ngrini zërat tuaj mbi zërin e Profetit..."* Pra, kur Profeti jeton dhe flet me ndonjë tjetër, nuk lejohet ngritja e zërit mbi zërin e tij.

Mirëpo, nëse qëllimi i thënies së tyre është gjithëpërfshirja dhe filozofia e dispozitës, atëherë kjo është e qartë tek ajeti i lartpërmendur e më gjerë. Për këtë arsye specialistët anullojnë "posaçërinë" e tekstit, duke mos e larguar përgjithësimin e lartpërmendur (kuptimi i ajetit përfshin etikën e të folurit në të gjallë të Profetit (s.a.v.s), si dhe pas

⁶ *Shih Tefsirin Mexhmaul Bejan, Tefsirin e Fahrud-din Raziut në fund të ajetit 2 të sures Mu'minune. Ajete 6: 7.*

ndërrimit jetë të tij). Sepse është e natyrshme që qëllimi këtu ka të bëjë me ruajtjen e etikës dhe respektimin e mejdanit të shenjtërisë së Profetit (s.a.v.s). Nga ky këndvështrim, nëse ngritja e zërit tek varri i Profetit (s.a.v.s) ka për qëllim cënimin e shenjtërisë së tij, s'ka dyshim që kjo nuk lejohet. Me përjashtim të rasteve kur zëri i lartë është për thirrjen e ezanit për namaz, ose lexim a këndim Kur'ani, ose hytbe, etj., në këto veprime e të ngjashme me këto, lejohen, qoftë në të gjallë të Profetit apo pas vdekjes së tij.

Kompaktësia islame në çdo gjë e në çdo vend

Vërtet, çështja e udhëheqjes nuk është e plotë nëse nuk i kushtohet rëndësi kompaktësisë mes radhëve. Nëse njerëzit do të vepronin sipas dëshirave të tyre -edhe pse ka udhëheqje - atëherë veprat nuk do të ishin fryt i një bashkëpunimi edhe pse drejtuesit janë të aftë për udhëheqje.

Shumica e ngjarjeve me fund negativ për bashkësinë apo disfatat që kemi përjetuar e kanë zanafillën tek kjo moskompaktësi mes radhëve. Sa të shumta janë humbjet që kanë goditur një ushtri të fuqishme apo mosarritja e suksesit në çështje me rëndësi madhore për një bashkësi, e të ngjashme me to, për shkak të kësaj që u përmend më lart. Edhe muslimanët e kanë provuar hidhësinë e kundërshtimit të këtyre mësimëve, si në kohën e Profetit (s.a.v.s), ashtu edhe pas vdekjes së tij. Disfata më e madhe që provuan muslimanët ka qenë në Betejën e Uhudit, e kjo erdhi si pasojë e moskompaktësisë në mendim e veprim të një grupi ushtarësh prej ushtrisë muslimane. Kur'ani e konsideron këtë çështje shumë të rëndësishme. Në të thuhet: **"O ju që besuat mos"**

Kuptimi i këtij ajeti, siç e thamë edhe më lart, është shumë i gjërë dhe përfshin çdo lloj fjale apo veprë në rang individ apo shoqërie në kundërshtim me mësimet e udhëheqjes. Këto fenomene kanë ndodhur edhe gjatë jetës së Profetit (s.a.v.s), kur disa persona nuk e morën në konsideratë urdhërin e tij, apo e kundërshtuan atë dhe më pas u penduan dhe qortuan veten e tyre ashpër. Ndër ato ndodhi përmendim:

- 1- Kur Profeti u nis për çlirimin e Mekës, në vitin e tetë të Hixhrit, ishte muaji Ramazan, dhe së bashku me të gjendeshin kalorës dhe këmbësorë. Në kohën që arritën në një vend të quajtur "*Kira'ul Gamim*", Profeti urdhëroi që të sillnin një enë me ujë në të cilën ai piu duke prishur agjërimin. Bashkë me të pinë edhe të tjerë. Çudi ishte me një grup njerëzish që nuk bënë ashtu siç bëri Profeti dhe kundërshtuan ta prishin agjërimin duke qëndruar të agjërueshëm. Profeti i quajti ata mëkatarë. Këtë ndodhi e kanë përcjellë shumë historianë e transmetues hadithesh.
- 2- Në Haxhin e Lamtumirës, në vitin e dhjetë të Hixhrit, Profeti (s.a.v.s) urdhëroi një njeri që të thërrasë: "Ai që nuk ka sjellë me vete kurban (bagëti), ta heqë ihramin dhe ta konsiderojë (haxhin e tij) Umre, dhe ai që ka sjellë me vete kurban, të qëndrojë i veshur me ihram." Mirëpo një grup njerëzish kundërshtuan dhe thanë: "Si ta heqim ihramin dhe Profeti është i veshur me ihram, a nuk është gjë e shëmtuar që ta kryejë haxhin pas umres dhe...."

3- Profeti e quajti jo të mirë atë që thanë dhe i qortoi e i fajësoi ata"⁷

Pyetje:

- 1- A ka ndonjë etikë të caktuar për daljen para Allahut në namaz?*
- 2- Çfarë lejohet të veprohet me zë të lartë te varri I Profetit (s.a.v.s)?*
- 3- Përmendni shkurtimisht dy ndodhitë që përmenden në këtë mësim.*

⁷ Biharul Anvar; Vëll 21, Fq 386.

Mësimi i dymbëdhjetë

1- Siguria e plotë shoqërore

S'ka dyshim se gjashtë mësimet që përmbajnë dy ajetet e lartpërmendura, nëse zbatohen në shoqëri, atëherë nderi dhe fisnikëria e asaj shoqërie do të jenë të garantuara në çdo anë. Asnjë person nuk përqesh të tjerët, as nuk e zgjat gjuhën e tij, as nuk mund ta fyejë me përdorimin e pseudonimeve përcmuese, as të paragjykojë për të keq, as të përgjojë e të mbartë fjalë rreth intimiteteve dhe skreteve të jetës së njerëzve dhe as nuk i mbulon të metat e tyre nëpërmjet përgojimit. Thënë ndryshe: Për njeriun ka katër kapitale të cilat duhet të mbrohen nëpërmjet kufijve të këtij ligji. Ato janë: Vetja e tij, pasuria, nderi dhe dinjiteti.

Islami kërkon që në shoqëri të sundojë siguria, jo vetëm të mjaftohet me ndalimin e goditjeve ndaj njeri-tjetrit, por njerëzit duhet të jenë të qetë edhe prej gjuhëve, madje edhe prej mendimve të këqija, ku çdo person të ndihet në intimitetin e tij i pacënuar nga "shigjetat" e akuzave dhe paragjykimeve. Kjo siguri arrihet vetëm në një shoqëri në të cilën ndjehet atmosfera e besimit dhe e mesazhit hyjnor. Profeti Muhamed (s.a.v.s) thotë: "Allahu e ka ndaluar gjakderdhjen e myslimanit, pasurinë e tij, nderin e tij dhe të menduarit keq (paragjykimin) për të." Paragjykimet e këqija jo vetëm që ndikojnë negativisht në personalitetin e një personi, por ato janë një fatkeqësi e madhe për atë operson, sepse ato janë shkak i largimit të tij nga bashkëpunimi me të tjerët dhe i krijojnë atij një botë të egër, të panjohur dhe të mënjanuar. Ajo çka e dallon jetën e njeriut me atë të kafshëve dhe i jep asaj bukuri dhe përsosmëri, është shpirti i bashkëpunimit shoqëror. Kjo gjë nuk arrihet, vetëm e vetëm nëse njerëzit mendojnë mirë për njeri-tjetrin. Ndërkaq, paragjykimet e këqija i shkëpusin lidhjet e bashkëpunimit dhe dobësojnë shpirtin shoqëror. E tillë është gjendja edhe me spiunimin, përgjimin dhe përgojimin. S'ka dyshim se ata që mbartin paragjykime të këqija, ata i frikësohen çdo gjëje (deri edhe hijes së tyre). Nuk gjejnë qetësi për të zgjidhur problemet që kanë, nuk kanë partner në aktivitetet e tyre dhe nuk gjejnë ndihmës e as mbështetës kur janë në fatkeqësi. Këtu po sqarojmë diçka: Fjala "dhann" (paragjykim) që është përdorur në këtë ajet ka kuptimin paragjykim i pabazë. Ndërsa, në rast se paragjykimi bazohet diku apo mbështetet në argument, ai quhet "paragjykim i konsideruar" dhe përqjashtohet nga ky rregull, siç është p.sh. paragjykimi i arritur prej dëshmisë së dy personave të drejtë.

2- Mos bartni fjalë, mos spiunoni e mos përgjoni!

Më lart mësuam se Kur'ani i ndalon kategorikisht të gjitha llojet e spiunimeve, përgojimeve dhe përgjimeve. Përderisa ajeti nuk përmban asnjë kushtëzim apo përveçim, atëherë ai tregon se, spiunimi i të tjerëve dhe zbulimi i sekretëve apo i intimiteteve të tyre është mëkat i madh. Por argumentet që ndodhin Brenda ajetit dhe jashtë tij, tregojnë se ky rregull ka të bëjë me jetën personale të individëve. Ky rregull vërtetohet edhe në jetën shoqërore. Por është e qartë se kur ky rregull ka lidhje me jetën shoqërore, atëherë çështja merr një natyrë tjetër, sepse edhe Profeti kishte caktuar

persona dhe i kishte urdhëruar ata që të zbulojnë lajme që kanë të bëjnë me shoqërinë. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se edhe shteti islam mund të ketë persona që konsiderohen “syttë” e tij, apo institucion të posaçëm informative që ka si synim mbrojtjen e shoqërisë, kurthe të cilat kanë si qëllim prishjen e sigurisë së saj. Ky lloj zbulimi është në interesin e përgjithshëm edhe nëse ndonjëherë u afrohet kufijve të jetës personale të ndonjë individi. Por ky veprim nuk duhet të bëhet shkak për shkatërrimin e këtij ligji bazë të Islamit, ku disa persona të zbulojnë sekretet personale të njerëzve me qëllim ngritjen e kurtheve dhe prishjen e sigurisë, si p.sh. hapja e letërkëmbimeve, përgjimi i telefonatave, bastisja e shtëpive etj. Nga këto nxjerrim si konkluzion se kufiri mes “spiunimit” me kuptimin negative dhe atij që përdoret për mbledhjen e informacioneve të domosdoshme me qëllim mbrojtjen e shoqërisë, është shumë hollë dhe delikat, prandaj duhet që drejtuesit e këtyre institucioneve të kenë parasysh këtë kufi me qëllim që të mos kryhet mëkat në zbulimin e sekreteve të njerëzve dhe të mos kërcënohet siguria e shoqërisë në përgjithësi dhe ajo islame në veçanti.

3- Përgjimi, mëkati më i rëndë dhe më i madh

Kapitalet më të rëndësishëm në jetën e njeriut janë nderi dhe dinjiteti. Çdo gjë që i kërcënon këto është njëlloj sikur të ketë kërcënuar jetën e tij. Nganjëherë cënimi i dinjitetit konsiderohet më i rëndë sesa vrasja e vetë personit. Për këtë, nganjëherë ndodh që mëkati i parë (cënimi i dinjitetit) të jetë më i madh se mëkati i vrasjes së një njeriu. Një prej urtësive të ndalimit të përgojimit është që kapitëlet e lartpërmendura më me vlerë të njeriut, të mos kanosen me rrezikun e përçarjes, si dhe të mos ofendohet personaliteti i njerëzve apo njolloset figura e tyre. Kësaj çështjeje Islami i kushton interes dhe i jep përparësi të madhe, sepse uniteti islam dhe solidariteti mes myslimanëve janë objektivat më të rëndësishëm dhe çdo gjë që i cënon apo dobëson ato (mes tyre edhe përgojimi), është e refuzuar. Një arsye tjetër është se përgojimi lind mendim të keq, dobëson marrëdhëniet shoqërore, shkatërron kapitëlet e vjera të njerëzve dhe lëkund bazat e bashkëpunimit shoqëror.

Përgojimi mbjell në zemra farën e smirës, të armiqësisë dhe nganjëherë shkakton vrasje dhe gjakderdhje. Kur themi se përgojimi është prej mëketeve të mëdha kemi parasysh ndikimet negative që ai shkakton, qofshin individuale apo shoqërore. Edhe transmetimet islame e konstatojnë këtë gjë. Këtu po përmendim disa prej tyre. Profeti Muhamed (s.a.v.s.) një ditë mbajti një hutbe dhe tyhirri me zë të lartë: “O ju njerëz që keni besuar me gjuhë dhe jo me zemër! Mos përgojoni myslimanët dhe mos zbuloni të metat e tyre, sepse ai që zbulon të metat e vëllait të tij, Allahu is zbulon të metat dhe e skandalizon në shtëpinë e tij!”

Në një thënie tjetër përmendet se Allahu (xh.sh.) e frymëzoi Musain (a.s.) duke i thënë: “Ai që vdes i penduar nga përgojimi do të jetë i fundit që do të hyjë në Xhenet dhe ai që vdes përgojues do të jetë i pari që do të hyjë në Xhehenem.” Profeti Muhamed (s.a.v.s.) ka thënë: “Përgojimi është më i shpejtë (arrin më shpejt) tek myslimani sesa kafshata e ushqimit të tij.” Transmetimet islame rreth kësaj çështjeje janë të shumta dhe po e mbyllim me këtë hadith të transmetuar nga Imam Sadiku, i cili thotë: “Ai që bart fjalë për besimtarin dhe nëpërmjet këtij veprimi synon ofendimin dhe shkatërrimin e

personaliteti të tij me qëllim që të mos jetë i konsideruar në mesin e njerëzve, atë person Allahu do ta nxjerrë nga vilajeti (rrethi i pranimi) i Tij dhe do ta fusë në vilajetin e shejtanit, i cili as ai nuk do ta pranojë.” Të gjitha këto transmetime flasin qartë për interesimin e lartë që i kushton Islami mbrojtjes së personalitetit të besimtarëve dhe shoqërisë së tyre.

Pyetje:

- 1- Cilat janë kapitalet më të rëndësishëm të njeriut?
- 2- Çfarë pasojash lënë paragjykimet e këqija?
- 3- A lejohet përgjimi për hir të interesit të përgjithshëm?
- 4- Ç’thotë Islami për përgojimin?
- 5- Përmendni një hadith të Profetit (s.a.v.s.) rreth përgojimit.

Mësimi i trembëdhjetë

1- Kuptimi i përgojimit

Përgojimi është të folurit e një personi për një person tjetër në mungesë të tij, duke zbuluar ndonjë të metë që gjendet tek ai person, qoftë kjo e metë në trup, në vepra, në moral, ose flet për personat që kanë lidhje me atë person, siç janë bashkëshortja, fëmijët etj. Fjalët që thuhën për vetitë e jashtme të një personi nuk konsiderohen përgojim, por nëse nëpërmjet këtij veprimi ka si qëllim ofendimin, ai veprim është haram (i ndaluar), p.sh. filani është i verbër, i çalë, i shkurtër, shumë i zi, pa mjekër...etj. Këtu sqarohet se përmendja e të metave të fshehta, çfarëdo qëllimi të ketë, është haram, ndërsa përmendja e të metave të dukshme, nëse bëhet me qëllim ofendimi, gjithashtu është haram. Kjo përsa i përket prezencës së të metave tek personi, ndërsa kur këto të meta nuk gjenden tek ai person, ky veprim quhet buhtan (shpifje) dhe mëkati i tij është akoma më i madh se ai i përgojimit.

2- Shërimi i përgojimit dhe pendimi ndaj tij

S'ka dyshim se përgjimi, ashtu sit ë gjitha cilësitë e këqija, dalëngadalë po shnërrohet në një sëmundje psikologjike, me anë të së cilës përgojuesi gjen kënaqësi kur ofendon të tjerët. Kjo është një sëmundje mjaft e rrezikshme për zemrën, prandaj duhet që përgojuesi të përpiqet për shërimin e shkaqeve shtytëse drejt përgojimit, të cilat ndodhen në brendësi të shpirtit të tij, siç janë kopracia, smira, urrejtja, mendjemadhësia, vetëpëlqimi... etj. Është detyrë e tij që të pastrojë vetveten duke synuar ngritjen e personalitetit dhe duke pasur parasysh pasojat e këqija të këtyre cilësive të përbuzura. Të pastrojë zemrën duke përmbajtur vetn, me qëllim që të arrijë të mbrojë gjuhën e tij prej ndytësive të përgojimit dhe më pas t'i drejtohet pendimit (teubeh). Përdërisa përgojimi është vepër me anë të së cilës cënohen të drejtat e njerëzve, atëherë përgojuesi, nëse ka mundësi, duhet t'u kërkojë ndjesë atyre që ka përgojuar, por pa e sqaruar objektin e përgojimit, sepse ndoshta do të ndodhin fatkeqësi më të mëdha me sqarimin e përgojimit. P.sh. ai duhet t'u thotë përciptas: "Nganjëherë të kam përgojuar, prandaj të kërkoj ndjesë dhe të më falësh." Nëse nuk mundësi të arrijë tek ata persona, ose nuk i njeh ata, ose nëse at kanë vdekur, ai duhet të kërkojë pendim tek Allahu dhe të veprojë punë të pëlqyera, sepse ndoshta Allahu për hir të atyre punëve e mëshiron dhe fal atë.

3- Disa përjashtime

Çëshjtja e fundit që duhet përmendur rreth përgojimit është se rregulla e përgojimit, ashtu si rregullat e tjera, ka përjashtimet e saj. Një ndër këto përjashtime është edhe konsultimi, pra kur një person pyet dikë, apo i merr mendimin dikujt për zgjedhjen e bashkëshortit apo bashkëshortes, partnerit në biznes...etj. Është emanet (objektivizëm fetar) që gjatë konsultimit për çështje të tilla të shfaqen të metat e dikujt nëse gjenden tek ai, me qëllim që më pas të mos i lindin problem myslimanëve. Ky lloj përgojimi në këtë pozitë nuk është haram. Duhet përmendur se nuk është haram vetëm praktikimi i

përgojimit, por edhe dëgjimi i tij, madje edhe ndejtja në ato vende ku bëhet përgojimi është haram. Në disa hadithe thuhet se kur ndodhesh në mesin e disa njerëzve përgojues, duhet t'i kundërshtosh dhe të mbrosh të përgojuarin. Sa e përsosur do të ishte ajo shoqëri e cila do të ruante këto parime të rëndësishme morale!

Pyetje:

- 1- Ç'është përgojimi?
- 2- Si t'i shërojmë shkaqet që çojnë në përgojim?
- 3- A ka përjashtime për përgojimin?

Mësimi i katërmbëdhjetë

Ajeti 13

“ O njerëz Ne ju krijuam ju prej një mashkulli e një femre, iu kemi bërë në popuj e fise që të njiheni. Vërtet më I miri I juaj është më I devotshmi ndër ju. Vërtet Allahu është I ditur”

Komentimi:

Devotshmëria , vlera më e lartë njerëzore:

Ajetet e lartëpërmendura u drejtoheshin besimtarëve (*O ju që keni besuar*), duke i ndaluar ata të kryejnë vepra që e çojnë shoqërinë islame në rrezik.

Ndërsa, ky ajet u drejtohet njerëzve në përgjithësi (**O ju njerëz**) duke u sqaruar atyre bazën më të rëndësishme, u garanton siguri dhe vazhdimësi, dallon ekuilibrin real të vlerave humane nga pseudovlerat mashtrimet e kota. Ajeti thotë: (*O ju njerëz, Ne ju krijuam ju prej mashkulli dhe femre dhe ju kemi bërë në popuj e në fise që të njiheni*).

Fjalja (*Ju krijuam ju prej një mashkulli e prej femre*) nënkupton origjinën e krijimit, pra gjeneza e njerëzve fillon nga Ademi dhe Hava. Meqenëse të gjithë e kanë prejardhjen tek një origjinë, atëherë asnjë fis nuk duhet t’i krenohet një tjetri duke u nisur nga përkatësia gjenetike. Kur Allahu (xh.sh) e ka krijuar një fis dhe i ka dhënë veçori dhe detyra të caktuara, këtë e ka bërë që të ruhet sistemi shoqëror i jetës së njerëzve! Sepse pikërisht ndryshimet apo dallimet nga një popull tek tjetri janë arsye që njerëzit të njihen me njëri - tjetrin. Sikur ata të ishin të ngjashëm dhe të kishin veçori të përbashkëta, atëherë shoqëria do të sundohej nga çrregullimi dhe përçarja.

Komentuesit kanë mendime të ndryshme rreth dallimit në mes fjalës “shuub” (popuj) që është shumësi i fjalës “sha’ab” (popull) dhe fjalës “Kabail” (fise) që është shumësi i fjalës “Kabiletu” (fis):

Një grup prej tyre thanë se kuptimi i fjalës “sha’ab” është më i gjërë se ai i fjalës “Kabileh”, sepse siç është e njohur në kohë që jetojnë me fjalën sha’ab (popull) quhen banorët e një atdheu.

Disa të tjerë thonë se fjala “shaab” ka për qëllim jo arabët, ndërsa “kabail” ka për qëllim arabët. Dhe së fundi një grup tjetër thonë se fjala “shaab” tregon për përkatësinë gjeografike e njerëzve të një grupi njerëzish, ndërsa “ kabileh” tregon për përkatësinë e një race apo gjaku.

Por me sa duket komentimi i parë është më i përshtatshëm se të tjerët.

Si do që të jetë, pasi Kur’ani shfaros të gjitha llojet e krenarive në kohën e *xhahilijetit* (para Islamit), dhe hedh poshtë mburjen farefosnore, drejtohet drejt një etaloni (vlere bazë) real I cili është *(më i miri prej jush tek Allahu është më i devotshmi)*.

Në këtë mënyrë Kur’ani “i vë vizën” të gjitha dallimeve të dukshme e materiale, dhe i jep prioritet çështjes së devotshmërisë e frikës ndaj Allahut (xh.sh) duke thënë se nuk ka asgjë më e përsosur se sa devotshmëria dhe se ajo është rruga e afrimit tek Allahu (xh.sh) e cila të çon drejt shpëtimit. Përderisa “tekva”-ja (devotshmëria) është veti e brendëshme shpirtërore, duhet që në fillim të jetë konstante në shpirt dhe në zemër.

Ndoshta ka shumë persona që thonë se ne jemi të devotshëm, por janë të pakët ata që e mbartin vërtet këtë cilësi dhe se Allahu e di më së miri këtë çështje siç thotë fundi i ajetit në vazhdim *(Vërtet Allahu është Gjithëdijsmi dhe i Gjithinformuari)*.

S’ka dyshim se vetëm Allahu i di dhe i njeh të devotshmit e vërtetë, sepse Ai (xh.sh) e njeh pastërtinë dhe kthjelltësinë e zemrave. Sipas kësaj diturie Allahu (xh.sh) i shpërblen ata, kurse ata që shtiren sit ë tillë, Allahu (xh.sh) do t’I dënojë duke u bazuar në diturinë e Tij (xh.sh) për mashtrimin e tyre.

Vlerat e pëlqyera dhe ato të papëlqyera

S’ka dyshim se çdo njeri duke u bazuar në natyrshmërinë e tij dëshiron të jetë krenar dhe i përsosur, për këtë ai përpiqet me të gjithë fuqitë e tij që të fitojë vlera.

Por bazat e vlerave ndryshojnë me ndryshimin e kulturave. Ndoshta në një vend vlerat e papëlqyeshme kanë zënë një pozicion të dukshëm në fjalorin e kulturës individuale, duke mos i lënë vend për vlerat e pëlqyeshme.

Një grup njerëzish mendojnë se vlera reale e tyre është përkatësia fisnore dhe për të lartësuar opinionin e fisit apo grupacionit të tyre, ata shfrytëzojnë çdo personalitet apo aktivitet në shërbim të “madhështisë” së tyre.

Në kohën e *xhahilijetit*, interesimi për fisin dhe krenaria për atë fis ishte çështja më e rëndësishme që arrinte deri në atë shkallë saqë dikush e konsideronte fisin e tij më të përsosur se fiset e tjera. Është për të të ardhur keq se këto mbeturina të *xhahilijetit* i gjejmë në brendësi të personave dhe shoqërive!!

Disa të tjerë, si argument të superioritetit shohin çështjen e pasurisë, e kështjellave, vilave lluksoze, shërbyesit të shumtë, etj. Për këto gjëra ata përpiqen vazhdimisht dhe këtyre u kushtojnë gjithçka.

Një grup tjetër i konsideron pozitat e larta politike dhe shoqërore, baza të personalitetit dhe vlerave shoqërore.

E kështu me radhë, çdo grup ndjek një rrugë të veçantë dhe zemrat e tyre anojnë nga një vlerë e veçantë, të cilën e konsiderojnë bazë të personalitetit të tyre.

Përderisa të gjitha këto çështje janë të lëkundëshme, materiale dhe kalimtare, atëherë një fe qiellore siç është Islami, nuk mund të jetë e një mendimi me to, por I konsideron të pavlefshme dhe ngre lart vlerën e vërtetë të njeriut, devotshmërinë.

Sipas pikëpamjes së Islamit vlerat e vërteta dhe reale të njeriut janë pastërtia e zemrës së tij, devotshmëria dhe besimi fetar. Ai nuk i kushton shumë rëndësi edhe çështjeve të rëndësishme, siç janë dituria dhe kultura, nëse ata nuk I përshtaten vijës së besimit, devotshmërisë dhe vlerave morale.

Është e habitshme që Kur'ani të shpallet në një ambient që interesohet për vlerat fisnore më tepër se vlerat e tjera!. Por Kur'ani i shkatërroi këto paganizma dhe e çliroi njeriun prej prangave të prejardhjeve fisnore, ngjyrës, racës dhe pasurisë duke e drejtuar atë kah njohja e vetvetes dhe ia mundësoi atij të gjejë "thesarin" e humbur dhe të zbulojë virtytet e larta që gjenden në brendinë e tij.

Janë interesante ato që përmenden rreth shkakut të zbritjes së këtij ajeti, i cili përfshin një pjesë të kushtetutës islame. Prej atyre shkaqeve janë:

Profeti (s.a.v.s) pas çlirimit të Mekës urdhëroi Bilalin që të thërriste ezanin. Bilali u ngjit në Qabe dhe fillojë ta thërrasë ezanin. Në ato momente "Attab ibn Usejd" (i cili ishte i lirë dhe jo skllav) tha: *"Falenderoj Allahun që babai im ka kaluar nga kjo jetë dhe nuk e ka parë atë"*. Harith ibn Hisham tha: *"A nuk gjeti tjetër njeri i Dërguari përveç këtij korbit të zi për të thirrur"*

ezanin?!" Atëherë zbriti ajeti i lartëpërmendur i cili sqaron bazat e vlerave reale.⁸

Disa komentues të tjerë thonë se ajeti ka zbritur kur Profeti urdhëroi disa *mevalij* të tij të martohen me vajzat e arabëve. (*Mevalij* janë robërit e çliruar prej pronarëve të tyre, ose janë joarabët mysliman).

Njerëzit u habitën nga ky veprim i Profetit dhe thanë: *"O i dërguari i Allahut, po na urdhëron të martojmë vajzat tona me këto mevalij?"* Atëherë zbriti ajeti:⁹

Në disa trasmetime lexojmë se një ditë Profeti mbajti një fjalim në Mekë dhe tha: *"O njerëz! Vërtet, Allahu ju largoi nga paturpësitë e xhahiliijetit dhe krenaria nëpërmjet baballarëve. Njerëzit janë dy lloje: 1) Të devotshëm dhe fisnikë dhe. 2) Të devijuar dhe të poshtër. Të gjithë njerëzit janë bijtë e Ademit dhe Allahu e krijoi atë nga balta. Ai (xh.sh) thotë: "Ne ju krijuam prej mashkulli dhe prej femre, ju kemi bërë popuj e fise që të njiheni, s'ka dyshim se më i miri prej jush tek Allahu është më i devotshmi."*¹⁰

Tabariu në librin e tij *"Adabun Nufus"* thotë: Kur ishin ditën e *"Teshrikut"* në Mina (që janë ditët 11, 12 dhe 13 të muajit Dhul Hixhheh), Profeti kishte hipur në deve dhe ju drejtua njerëzve duke u thënë: *"O njerëz! Vërtet Zoti juaj është Një dhe babai juaj është një. Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit, as i ziu ndaj esmerin e as i kuqi ndaj të ziut vetëm se me devotshmëri. A nuk njoftova? Ata thanë: Po. Ai (s.a.v.s) tha: "I pranishmi të njoftojë atë që mungon. "*

Në një hadith tjetër Profeti (s.a.s.v.s) ka thënë: *"Vërtet, Allahu nuk shikon në prejardhjen dhe në origjinën tuaj, as në trupat tuaj, as në pasuritë tuaja, por Ai shikon në zemrat tuaja. Ai që e ka zemrën të pastër, është i dashur tek Allahu. S'ka dyshim se ju jeni bijtë e Ademit dhe më i dashuri juaj tek Ai është më i devotshmi i juaj".*

Është për t'u çuditur se edhe pse gjenden këto thënie kuptimplote, akoma vazhdon të haset në mesin e myslimanëve krenaria (më saktë mburrja) përshka të origjinës, prejardhjes dhe gjuhës. Ata konsiderojnë si parësore gjenezën dhe gjuhën mbi vëllazërinë islame dhe unitetin fetar. Me këtë veprim ata ringjallin fanatizmin *xhahiliijetit* dhe me gjithë goditjet që vijnë si pasojë e këtij veprimi, ata nuk duan të zgjohen e të kthehen në rregullin e

⁸ Ruhul Bejan, Vëll. 9, Fq. 90. Ashtu siç transmetohet edhe në tefsirin e El Kurtubijut Vëll. 9, Fq. 6160.

⁹ Po aty.

¹⁰ *Tefsiru El-Kurtubij* V. 9. F. 6161.

pastër dhe hyjnor të Islamit! (Allahu i mbroftë të gjithë prej të keqes së fanatizmit xhahilij).

Islami i luftoi dhe i lufton të gjitha ngjyrat dhe format e fanatizmit *xhahilij*, me qëllim që myslimanët në të gjithë botën (të çdo fisi dhe kombi qofshin), të jenë nën një flamur të përbashkët atë të vëllazërisë islame dh eta lënë mënjane fanatizmin xhahilij, sepse siç e ka përshkruar Profeti Muhamed (s.a.v.s) në një hadith të përcjellë nga Muslimi ai (*fanatizmi xhahilij*) është i fëlliqur.

Po përse qëndroi kjo ndjenjë e ngulitur në mendjet e shumë personave që pretendojnë se janë muslimanë, ndjekin Kur'anin dhe vëllazërinë islame?! Këtë nuk e dimë!!

Sa e përsosur do të ishte sikur shoqëria të ngrihej mbi etalonin real (vlerën bazë) të moralit islam (*vërtet më i miri prej jush tek Allahu është më i devotëshmi*)?

Është e vërtetë se devotshmëria, ndenja e përgjegjësisë, kundërshtimi i epsheve, interesimi për të vërtetën, pasërtinë dhe drejtësia janë bazat e vlerave të njeriut. Edhe pse këto vlera janë bazë, ato janë harruar, janë nënvleftësuar në shoqërinë e sotme dhe vendin e tyre e kanë zënë vlerat false.

Sistemi i vlerave në kohën e Xhahilijetit (i cili kishte për bazë krenarinë me fiset dhe baballarët) nuk nxirrte produkt tjetër përveçse hajdutë dhe grabitqarë. Por, me ndërrimin e atij sistemi dhe me ringjalljen e besimit bazë: (*Vërtet, më i miri i juaj tek Allahu është më i devotëshmi*), Islami nxorri njerëz si Selman Farisiu, Ebu Dherri, Ammari, Jasiri, Mikdadi e të tjerë.

Këtu po e mbyllim me një hadith të Profetit Muhammed (s.a.v.s) i cili ka thënë: “ *Të gjithë ju jeni bijtë e Ademit, dhe Ademi u krijua prej balte. Kombet të ndalojnë krenarinë me baballarët ose do të jenë më të parëndësishëm tek Alahu se sa Xhi’lan -ët*” ¹¹

¹¹ *Tefsiri “Fi Dhilalil Kur’an”, i Sejjid Kutubit, Vëll. 7, Fq. 538. (Xhi’lanët janë insekte që rrijnë në vende me vesë dhe që kanë erë të keqe.)*

Pyetje:

- 1- Ç'është devotshmëria?*
- 2- Si e konsideron Kur'ani devotshmërinë?*
- 3- Çfarë kuptimi ka fjala "shu'ub"?*
- 4- Përmendi historinë që flet reth Bilalit.*
- 5- Përmendni thënien e Profetit në ditët e Teshrikut.*
- 6- Si e konsideron Profeti në një thënie të tij krenarinë me baballarët?*

Mësimi i pesëmbëdhjetë

E vërteta e devotshmërisë:

Siç e pamë më lart, Kur'ani e ka bërë devotshmërinë një prej karakteristikave dalluese të cilën e konsideron bazë për njohjen e vlerave humane.

Në një ajet, Kur'ani e konsideron devotshmërinë furnizimin më të përsosur *(dhe furnizohuni se vërtet furnizimi, më i mirë është devotshmëria)*.

Në të kaluarën, udhëtarëve, para se të niseshin për udhëtim, u duhej të furnizoheshin me ushqim e pije për ditët që do të kalonin në udhëtim. Në këtë ajet kemi ilustrim artistik *(tesuriun fenij)*. Pra, duke qene se njeriu në këtë jetë është udhëtar drejt Ahiretit, furnizimi i tij më i përsosur dhe i vetmi që do t'i hyjë në punë është devotshmëria. Në suen "A'raf", devotshmëria është cilësuar si petk (veshje), **(dhe petku i devotshmërisë, ai është më i mirë.)**

Në ajetet e tjera Kur'ani e konsideron devotshmërinë një prej bazave themelore të thirrjes së Profetëve dhe në disë ajete të tjera e ngre më lart devotshmërinë duke thënë se Allahu është *ehlu tekva* (i denji për devotshmëri) (Shih Sure Mudethir, ajeti 56.)

Devotshmëria është dritë nga Allahu (xh.sh), sepse kur ngulitet ajo bëhet dituri dhe njohje. Kur'ani thotë: *(frikësojuni Allahut që Ai t'iu mësojë juve)* Bekare 282.

Në disa ajete Kur'ani e bashkëshoqëron devotshmërinë me mirësjelljen, *(bashkëpunoni në mirësjellje dhe devotshmëri) më pas me drejtësinë (bëni drejtësi se ajo është më afër devotshmërisë)*.

Tani duhet të shohim se cila është e vërteta e devotshmërisë, e cila konsiderohet kapitali më i lartë shpirtëror dhe krenaria më e madhe e njeriut.

Disa ajete në Kur'an zbulojnë të vërtetën e devotshmërisë. Në disa vende përmendet "zemra" si vendqëndrim i saj. Njëri prej atyre ajeteve është thënia e Allahut (xh.sh): *"Ata janë të cilët Allahu, ua ka sprovuar zemrat me devotshmëri"*.

Në disa ajete të tjera gjejmë se **tekva-**ja (devotshmëri) është e kundërta e **fuxhur-it** (shthurjes) siç është ajeti 8 i sures Shems.

Çdo punë që rrjedh nga shpirti i besimit, i sinqeriteti dhe qëllimi i drejtë, Kur'ani e konsideron sit ë devotshme. Ai e cilëson "Xhaminë Kuba" (në Medinë) sit ë themeluar mbi devotshmëri, në kundërshtim me "Xhaminë Dirar", të cilën e ndërtuan hipokritët për t'iu kundërvënë muslimanëve. Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë: *(Vërtet xhamia e ngritur me devotshmëri që ditën e parë, e meriton të shkohet në të)* Teube108.

Prej ajeteve të lartëpërmendura del në pah se **tekua**-ja është ndjenjë përgjegjësie, e cila sundon ekzistencën e njeriut. Kjo për shkak të ngulitjes së besimit në zemrën e tij, i cili e mbron nga devijimet, mëkatet dhe e fton në vepra të mira e në bamirësi. Nëpërmjet saj, njeriu i pastron punët prej ndotjeve morale dhe pastron qëllimin dhe mendimin e tij nga çdo dyshim.

Po të kthehemi tek origjina gjuhësore e fjalës **tekua**, do të arrijmë në të njëjtin konkluzion, sepse fjala "tekua" rrjedh prej fjalës (**uikajetu**), e cila do të thotë përpjekje për t'u mbrojtur nga diçka. Në Kur'an ka kuptimin e mbrojtës së vehtes prej ndotjeve në përgjithësi. Disa dijetarë të famshëm përmendin tre faza për **takvan**-në.

- 1) Mbrojta e vehtes prej dënimit të përhershëm nëpërmjet besimit të rregullt.
- 2) Largimi nga çdo mëkat dhe mënjanimi i tyre (jo vetëm lënia)në përgjithësi nga çdo gjuhë.
- 3) Durimi ndaj çdo gjëje që punëson zemrën dhe e largon atë nga e vërteta. Është e natyrshme se praktikimi i adhurimeve, mënjanimi ndaj mëkatëve dhe ndjekja e rrugëve të moralit, e bëjnë devotshmërinë të ngulitet në zemër dhe konkluzioni i kësaj ngulitje është shfaqja e dritës së bindjes dhe e besimit në brendësi të njeriut. Sa më shumë të shtohet drita e devotshmërisë, aq më shumë shtohet drita e bindjes. Këtu përmendim se devotshmëria është fryt i pemës së besimit dhe për të patur këtë frut të rrallë e të shtrenjtë duhet që bazat e imanit të jenë të ngulitura dhe të qarta.

Pyetje:

- 1- Si është cilësuar devotshmëria në suren "A'raf"?
- 2- Me çfarë e bashkëshoqërojnë disa ajete devotshmërinë?
- 3- Sa faza të tekuasë përmendin dijetarët?

Mësimi i gjashtëmbëdhjetë

Ajetet 14 - 15

“Arabët e shkretëtirës deklarojnë: “Ne besojmë”. Thuaju: “Ju nuk keni besuar! Por më mirë thoni: ‘Ne përulemi’, pasi besimi ende nuk ka hyrë (si duhet) në zemrat tuaja. E, nëse i bindeni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk do t’ju pakësohet asgjë prej veprave tuaja. Sigurisht, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Ata janë besimtarë të vërtetë.”

Shkaku i zbritjes:

Komentuesit duke përmendur shkakun e zbritjes së dy ajeteve të lartpërmendura kanë thënë: “Në Medine erdhi një grup njerëzish prej fisit Esed për shkak të thatësisë që i preku ata. Kur shkuan tek Profeti ata shqiptuan dy dëshmitë me shpresë se do të merrnin diçka prej tij (s.a.v.s). Ata i thanë Profetit se fiset arabe u hipën kuajve dhe ngjeshën shpatat për t’ju luftuar ju, por ne kemi ardhur tek ti sëbashku me fëmijët tanë dhe gratë tona jo për t’ju luftuar.

Me këtë metodë ata donin që t’i shprehnin mirënjohje Profetit (s.a.v.s). Atëhere zbritën ajetet e lartpërmendura duke zbuluar se, Islami i tyre është i sipërfaqësor dhe se akoma në zemrat e tyre nuk vlon besimi. Pastaj, nëse janë besimtarë nuk duhet që ata të falenderonin Profetin për besimin sepse, Allahu është Ai që i begaton ata dhe i udhëzon në rrugën e besimit.

Komentim

Dallimi në mes Islamit dhe Imanit

Ajeti i mëparshëm bënte fjalë për bazën e vlerave humane, e cila ishte devotshmëria dhe se ajo ishte fryt i pemës së besimit, i cili i ka rrënjët thellë në zemra.

Në këto dy ajete sqarohet e vërteta e Imanit (Besimit).

Ajeti i parë thotë **“Arabët e shkretëtirës deklarojnë: ‘Ne besojmë’.** Thua ju: **“Ju nuk keni besuar! Por më mirë thoni: ‘Ne përulemi’, pasi besimi ende nuk ka hyrë (si duhet) në zemrat tuaja.** Sipas thënies së ajetit ka dallimi mes Islamit dhe Imanit. Islami ka formë të jashtme. Ai që dëshmon dy dëshmitë, ai ka hyrë në rradhët e muslimanve dhe u nënshtrohet rregullave dhe ligjeve të tyre, ndërsa, besimi është çështje reale dhe e brendëshme, vendi i të cilit është zemra e njeriut. Ajo çfarë thuhet me gojë apo duket nga jashtë është për të shfaqur islamin - dhe ndoshta gjenden nxitje materiale dhe interesa personale, ndërsa për imanin gjenden nxitje shpirtërore të cilat e kanë burimin tek dituria.

Imani është shkaku i frytit të devotshmërisë në degët e pemës së tij të palëkundura. Këtë e tregon edhe hadithi i Profetit (s.a.v.s) i cili ka thënë: **“Islami është i dukshëm dhe imani është në zemër”**¹².

Në një hadith tjetër thuhet: **“Imani është dëshmi e shoqëruar me vepër, ndërsa Islami është dëshmi pa vepër”**.¹³

Më poshtë ajeti shton (E, nëse i bindeni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk do t’ju pakësohet asgjë prej veprave tuaja.) pra, , Allahu do t’ju japë shpërblimin e punëve tuaja të plotë, pa asnjë mangësi. Kjo për shkak se, vërtet Allahu është Falës dhe Mëshirues.

Përmbledhja e kuptimit të ajetit është: Nëse ju jeni që besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij me besim në zemër (shenjë e të cilit është përulja juaj ndaj Allahun dhe urdhrave të të Dërguarit), s’ka dyshim se veprat tuaja janë të pranuar dhe Allahu ju shpërblen plotësisht dhe në shenjë pranimi të këtyre punëve Ai ju fal gjynahet, sepse Allahu është Falës dhe Mëshirues.

Meqenëse arritja tek imani nuk është diçka e lehtë, ajeti në vazhdim flet për shenjat e tij, të cilat bëjnë dallimin në mes besimtarit dhe myslimanit, si dhe dallimin në mes të vërtetit dhe gënjeshtarit duke thënë: **“Besimtarë të vërtetë**

¹² Mexhmaul Bejan: Vël. 9, Fq. 138

¹³ El Kafij, Vëll. 2, Hadithi 1

janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Ata janë të vërtetë ".

Është e vërtetë se shenja e parë e imanit është të përqëndruarit në rrugën e Islamit. Shenja e dytë është xhihadi (sakrifica) me pasuri dhe shenja e tretë është sakrifica me veten, e cila është më e rëndësishmja.

Si ka mundësi që Imani të mos jetë i ngulitur në zemrën e një personi i cili nuk ngurron të sakrifikojë me pasurinë dhe me shpirtin e tij në rrugën e më të dashurit (Allahut)?

Për këtë ajeti përfundon me thënien (*Ata janë të vërtetë*). Ky është kufiri që ka caktuar Islami për njohjen e besimtarëve të vërtetë dhe për t'i dalluar ata nga gënjeshtarët të cilët shtiren si muslimanë. Kjo nuk është e veçantë vetëm për të varfërit e fisit Esed, por është për çdo kohë dhe për çdo vend me qëllim që të dallohen besimtarët nga ata që shfaqin formalisht Islamin. Nëse nuk do ta zbatojmë këtë parim të Kur'anit dhe nuk praktikojmë këtë etalon për të njohur besimtarët e vërtetë për të bërë dallimin e tyre nga të tjerët, nuk do të arrijmë të dimë se sa besimtarë janë të vërtetë në mesin e milionave që thonë se jemi muslimanë.

Pyetje:

- 1- Përmendni shkakun e zbritjes së këtyre dy ajeteve.**
- 2- Cili është dallimi mes Islamit dhe Imanit?**
- 3- Përmendi disa thënie të Profetit (s.a.v.s) rreth kësaj çështjeje.**
- 4- Përmendi shenjat e dallimit mes besimtarit dhe muslimanit**

Mësimi I shtatëmbëdhjetë

Ajetet 16-18

“Thuaju: “Vallë, a do ta njoftoni Allahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka?! Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.”

“Ata e quajnë si favor për ty që kanë pranuar Islamin. Thuaju: “Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamin; përkundrazi, Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!”

“Allahu i di fshehtësitë e qiejve dhe të Tokës. Allahu i sheh të gjitha ato që bëni ju.”

Shkaku i zbritjes

Disa komentues thonë se, tek Profeti (s.a.v.s) erdhi një grup beduinësh (banorë të shkretëtirës) dhe u betuan se ishin të singertë në atë që pretendonin, pra ishin besimtarë nga jashtë dhe nga brenda. Atëherë zbriti ajeti i gjashtëmbëdhjetë duke i tërhequr atyre vëmendjen që të mos betohen sepse, Allahu e njeh më së miri të jashtmen dhe të brëndëshmen e tyre dhe se Atij (xh.sh) nuk i fshihet asgjë ç'ka ndodhet në tokë e qiej.

Komentimi

Ajetet e mëparshme sqaronin shenjat besimtarëve të vërtetë, ndërsa ky ajet u tërheq vëmendjen atyre beduinëve duke u thënë se nuk është nevoja e këmbënguljes dhe e betimit për besimin tuaj. Po ashtu ky ajet përfshin të gjithë ato njerëz të ngjashëm me ato persona që shkuan tek Profeti, sepse çështjen e besimit dhe të mosbesimit më së miri e din vetëm Allahu (xh.sh) që është i ditur për çdo gjë.

Në metodikën e ajeteve gjendet qortim, ku ajeti i parë thotë:

“Thuaju: “Vallë, a do ta njoftoni Allahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka?!”

Dhe si dëshmi të plotë rreth diturisë së pakufizuar të Allahut (xh.sh) ajeti shton: **Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.**" Ai (xh.sh) me diturinë e Tij është kudo

Ai është më afër njerëzve sesa damari i qafës së tyre. Ai e di se çfarë gjendet në zemrat e tyre.

Meqenëse çështja është e tillë atëhere, nuk është e nevojshme që ne ta shprehim çështjen e besimit.

Përderisa Allahu është i Gjithdijshëm për gjithçka, përse këmbëngulni, që t'i bëni të ditur Allahut besimin tuaj?

Më poshtë Kur'ani kthehet tek fjalët e beduinëve kur i përmendën

Profetit se ata e pranuan Islamin në kohën kur fiset e tjera e luftuan atë.

Në përgjigje të thënieve të tyre Kur'ani thotë: **"Ata e quajnë si favor për ty që kanë pranuar Islamin. Thuaju: "Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamin; përkundrazi, Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!"**

Fjala "*minneh*" që do të thotë "mirënjohje", ka kuptimin e një mjeti të posaçëm peshues në të cilin peshohet. Pastaj kjo shprehje është përdorur për çdo mirësi të shtrenjtë dhe të çmueshme.

Mirënjohja është dy lloje:

1-Nëse në të gjenden anë praktike, siç është dhënia e diçkaje ose të dhuruarit e mirësisë, kjo është e lavdërueshme. Në këtë grup hyjnë dhuntitë e Allahut (xh.sh) për krijesat e Tij.

2- Nëse është shprehimore, pra, kur njerëzit e përmendin mirësinë e bërë, pasi e kryejnë atë. Në këtë rastajo është e papëlqyer dhe jo e dëshiruar.

Diçka tjetër interesante gjendet në fillim të ajetit i cili thotë: "... *ta përmendin ty islamin e tyre* " i cili dëshmon se ata nuk janë të singertë në besimin e tyre. Dhe në fund të ajetit thuhet: **përkundrazi, Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!"**

Para çdo gjëje besimi i jep njeriut një kuptim të ri rreth botës ekzistuese, zbulon perdet e vetëpëlqimit dhe mburrjes, i zgjeron atij horizontet e të menduarit dhe e njeh atë me madhësinë e krijimit të tij.

Besimi është ndriçues i brendisë së njeriut dhe i ringjalljes së vlerave humane që gjenden në brendinë e tij. Ai i jep njeriut, dituri, fuqi, krenari, pozitë, singëritet, falje, personalitet, tolerancë, etj dhe e bën atë të fortë e të dobishëm, pasi ishte ekzistencë e dobët.

A është kjo mirësia me anë të së cilës Allahu e ka begatuar njeriun, apo përmendja e Islamit që I bënë ata njerëz të Dërguarit?!!

Të gjitha adhurimet, janë hapa udhëzuese drejt përsosmërisë. Ato forcojnë zemrën, mposhtin epshet e papëlqyera, forcojnë shpirtin e sinqeritetit dhe fuqizojnë unitetin e shoqërisë.

Çdo adhurim është një mësim i përkryer për edukimin dhe ato janë fazat drejt përsosmërisë.

Nga ky këndvështrim duhet që, njeriu gjithmonë dhe në mënyrë të pandërprerë të falenderojë Allahun (xh.sh) për mirësitë që Ai ia dhuron atij, që ai t'i bëjë sexhde (përulet) Atij në çdo namaz, apo ibadeti tjetër, duke e falenderuar Atë për çdo gjë

Nëse njeriu ka këtë mendim rreth besimit ai nuk do ta shohë veten e tij mirënjohës por do ta shohë borxhli para Allahut dhe të Dërguarit të Tij për të gjitha ato të mira. Duke qenë i tillë, ai i kryen ibadetet me dashuri të zjarrtë, ecën në rrugën e përuljes para Allahut I sigurt në shpërblimin që e prët.

Kur Allahu e shpërblen atë, ajo do të jetë një tjetër mirësi dhe kënaqësi për njeriun, sepse të gjitha veprat e mira janë në dobi të vetë njeriut.

Udhëzimi i Allahut, siç e sqaruam është mirësi nga Ai (xh.sh), dërgimi i të dërguarve po ashtu, është mirësi tjetër si dhe mbarësia për kryerjen e ibadeteve është një mirësi e madhe, por shpërblimi në fund do të jetë mirësi mbi mirësitë dhe begati mbi begatitë.

Në fund të ajeteve që po përmendim, të cilat janë edhe ajetet e fundit të sures Huxhurat, ndodhet një dëshmi e vërtetë për atë që thuhet në ajetin e lartpërmendur e cila është dituria e Allahut (xh.sh). Ajeti thotë: **“Allahu i di fshehtësitë e qiejve dhe të Tokës. Allahu i sheh të gjitha ato që bëni ju.”**

Mos këmbëngulni, duke pretenduar që jeni vërtet besimtarë dhe nuk është nevoja të betoheni, sepse Allahu është prezent në thellësi të zemrave tuaja. Ai është i Gjithdijshtëm për ato që fshihen në qiej e në tokë. Si ka mundësi që të mos dijë Ai, se çfarë fshihet në zemrat dhe gjokset tuaja kur dihet se Ai është krijuesi i tyre?!

O Allah! Ti na begatove me dritën e besimit, prandaj të lutemi Ty për mirësinë e madhe të udhëzimit që të na i forcosh zemrat tona në këtë rrugë dhe të na drejtosh në rrugën e përsosmërisë.

O Allah! Ti je i Gjithdijshtëm për ato që gjenden në zemrat tona, Ti i di qëllimet tona, na i mbulo të këqijat para syve të njerëzve dhe na i mbulo të ligat tona me bujarinë Tënde, o Bujar.

O Allah! Na mbarëso në zbukurimin me virtytet dhe moralët e larta të cilat i përmende në këtë sure, me qëllim që të nguliten në mendjet, zemrat dhe shpirtërat tanë.

Amin o Zot i botëve.

Pyetje:

- 1- Përmendi shkakun e zbritjes së ajeteve 16-18.**
- 2- Përse I qorton ajeti beduinët?**
- 3- Çdo të thotë fjala “minneh”?**
- 4- Sa lloje është mirënjohja?**
- 5- A duhet njeriu të këmbëngulë duke treguar besimin e tij?**
- 6- Thoni rolin e besimit te njeriu**